

**AKT THEMELIMI I  
SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ PREMIUM BRANDS DISTRIBUTION” shpk**

Në Tiranë, sot më datë 27,12,2021 ne të poshtëshënuarit:

- 1- **Mirela Cano**, shtetase shqiptare e datëlindjes 04/11/1965, lindur në Korçë, dhe banuese në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal G 56104042V dhe
- 2- **Enada Zeqo**, shtetase shqiptare e datëlindjes 20/12/1976, lindur në Korçë, dhe banuese në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal H66220055W

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “PREMIUM BRANDS DISTRIBUTION “ shpk,

**Neni 1**  
**Emri, Forma**

- 1.1 Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet “**PREMIUM BRANDS DISTRIBUTION” SHPK** dhe më poshtë do të quhet “Shoqëria”.
- 1.2 Kjo shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ( “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

- 2.1 Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

**Neni 3**  
**Selia**

- 3.1 Në momentin e krijimit Selia e Shoqërise ndodhet ne adresën: “Rr. Dhaskal Tod’hri”, Nr. 35, Kashar, Tirane, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim te ortakëve. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të republikes së Shqipërise.



**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

4.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Import-eksport, shitje me shumice dhe pakice të tekstileve, të veshmbathjeve, aksesoreve të ndryshëm, produkte lëkure, canta, kepuce, parfume, artikuj kozmetike dhe estetike, bizhuteri, artikuj të ndryshëm industriale si dhe të gjitha veprimtaritë shtesë në lidhje me sa më sipër duke përfshirë ofrimin e shërbimeve. Në mënyrë që të përmbushë objektin e mesipër, Shoqëria ka të drejtë: Të lidhë çdo lloj kontrate ose marrëveshje me individë ose me entitete publike ose private, shoqëri, qeveri dhe organizata shqiptare ose të huaja; Të themelojë shoqëri të çdo lloji ose të marrë pjesë në shoqëri shqiptare ose të huaja ose shoqëri të thjeshta si dhe në lloje të ndryshme aktiviteti, që kanë objekt të njëjtit ose të ngjashëm; Të themelojnë dege ose agjenci në Shqipëri ose jashtë saj; Të përfaqësojë biznese shqiptare ose të huaja të lidhura me objektin e Shoqërisë. Të ndermarre çdo veprimtari tjetër tregtare ose veprimtari tjetër dhe të ndermarre çdo veprim tjetër ligjor ose transaksion që lidhet direkt ose indirekt me objektin e Shoqërisë, ose që synon në mënyrë direkt ose indirekte përmbushjen e objektit të Shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë në mënyrë dytesore dhe jo të drejtëpërdrejtë, me qëllim përmbushjen e objektit të Shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksione në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme të cilat mund të gjykohen si të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet ndihmëse ose veprime të lidhura, si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme ose ato që konsiderohen të nevojshme në çdo kohë për të arritur qëllimin e biznesit të Shoqërisë duke zbatuar ligjin, me përjashtim të veprimtarive financiare dhe/ose pjesëmarrëse kundërt publikut dhe të veprimtarive profesionale të rezervuara.


**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

5.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

6.1 Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 200.000 lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

- 1- **Mirela Cano**, shtetase shqiptare e datëlindjes 04/11/1965, lindur në Korçë, dhe banuese në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal G 56104042V, zotëron 1 (një) kuota me vlerë 100.000 lekë e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.  
dhe
- 2- **Enada Zeqo**, shtetase shqiptare e datëlindjes 20/12/1976, lindur në Korçë, dhe banuese në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me



numër personal H66220055W, zotëron 1 (një) kuote me vlerë 100.000 lekë e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)


Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

### Neni 7 Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### Neni 8 Organi Vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



- 8.2 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

**Neni 9**  
**Administrimi**

- 9.1 Administratorë të shoqërisë janë:

- Mirela Cano, shtetase shqiptare e datëlindjes 04/11/1965, lindur në Korçë, dhe banuese në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal G 56104042V.
- Kohëzgjatja e emërimit të Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga momenti që ky akt nënshkruhet, me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati.

**Neni 10**  
**Baza Ligjore**

- 10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 11**  
**Dispozita përfundimtare**

- 11.1 Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.  
Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "PREMIUM BRANDS DISTRIBUTION" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES**

Znj. Mirela CANO





Znj. Enada ZEZO





Tiranë, më datë 27,12,2021